

VENDIM
Nr.310, datë 21.4.2011

**PËR PËRCAKTIMIN E KOSTOS MESATARE, LEKË PËR METËR KATROR,
PËR OBJEKTET SHITËTËRORE TË TRANSFORMUARA NË FOND
BANESASH, KALUAR NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË ENTIT
KOMBËTAR TË BANESAVE, ME QËLLIM PRIVATIZIMI, PËR BANORËT
POSEDUES, SIPAS VENDIMEVE TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE,
*PERIUDHËS 2009-2013***

(Ndryshuar me VKM nr. 491, datë 13.6.2013)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 34/1 të ligjit nr.9232, datë 13.5.2004 “Për programet sociale të strehimit në zonat urbane”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Për të gjitha objektet shtetërore, të transformuara në fond banesash me investimin e qytetarëve gjatë viteve 1991 e në vijim dhe të kaluara në përgjegjësi administrimi të Entit Kombëtar të Banesave, me qëllim privatizimi, për banorët posedues, me vendimet përkatëse të Këshillit të Ministrave të *periudhës 2009-2013*, kostoja mesatare, lekë për metër katror, të jetë 35 për qind e çmimit njësi për sipërfaqe ndërtimi, të miratuar me vendimin nr.815, datë 9.12.1996 të Këshillit të Ministrave, referuar vitit 1995, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohet Enti Kombëtar i Banesave të kryejë përllogaritjet sipas pikës 1 të këtij vendimi, për të gjitha kontratat e lidhura gjatë periudhës 2010-2011 dhe të ftojë, brenda 6 (gjashtë) muajsh, lidhjen e kontratave të reja me të gjithë poseduesit, të cilët nuk kanë kryer ende procedurën.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha